



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Njësia Org. Org. Jodi. Org. Unit	Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.
Nr. i Faqeve Broj Stranica No. of Pages	Data: Datum Date:
02	681
02	14.09.2023



DATE/A:	14.09.2023
PËR/ZA/TO:	Sekretarët e Përgjithshëm të ZKM dhe Ministrive
PËRMES:	Znj. Krenare Sogojeva Dermaku, Komisionere për Informim dhe Privatësi <i>Krenare Sogojeva Dermaku</i>
NGA/OD/FROM:	Znj. Lumnije Demi, Drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia për Informim dhe Privatësi <i>Lumnije Demi</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe hartimin e Politikave të Privatësisë

I/E nderuar,

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka përcaktuar se kontrollues i të dhënave personale është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 37, paragrafi 1, i po të njëjtit Ligj ka përcaktuar se kontrolluesi dhe përpunuesi (institucioni publik) caktojnë një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave, nëse përpunimi kryhet nga një organ publik. Në kuptim të kësaj, institucioni juaj si kontrollues, por edhe përpunues i të dhënave personale, ka obligim ligjor caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Marrë për bazë këtë që u tha më lartë, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), si mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim të mbështetjes për përmbushjen e obligimeve ligjore nga ana juaj, kërkon që:

- Të caktoni me Vendim Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Të publikoni Vendimin në faqen zyrtare të institucionit tuaj dhe kontaktet e zyrtarit të caktuar (postën elektronike (e-mail) dhe numrin kontaktues zyrtar);
- Të njoftoni Agjencinë për Informim dhe Privatësi për caktimin e zyrtarit përgjegjës dhe ndryshimin e tij/saj.

Për të përmbushur kërkesat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të ketë njohuri lidhur me organizimin, strukturën dhe punën e institucionit dhe të mos jetë në konflikt të interesit,

respektivisht pozita të larta drejtuese (si udhëheqësi i administratës, udhëheqësi i drejtorisë së arsimit, shëndetësisë, udhëheqësi i burimeve njerëzore ose i departamentit të TI-së etj.), apo edhe pozita të tjera që janë përgjegjëse për përpunimin e të dhënave personale.

Përveç kësaj, neni 12 i Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka përcaktuar edhe obligimin e secilit kontrollues t'i ofroj informacione subjektit të të dhënave për identitetin e kontrolluesit, kontaktin e zyrtarit të mbrojtjes së të dhënave, qëllimin e përpunimit, bazën ligjore për përpunim, interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë, marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit, nëse kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përshtatshmërie të Agjencisë (referuar Vendimit Nr.01/2021 të Komisioneres për Informim dhe Privatësi për shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave personale (<https://aip.rks-gov.net/download/vendim-lista-e-vendeve-me-nivel-te-duhur-te-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale/>)).

Kriteret e përcaktuara më lartë, kontrolluesi duhet t'i zbatojë përmes hartimit, miratimit dhe publikimit të Politikave të Privatësisë.

Andaj, referuar kësaj, **kërkojmë që të hartoni dhe publikoni në faqen tuaj zyrtare Politikat e Privatësisë, me përmbajtje sipas kërkesave të nenin 12 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Agjencia për Informim dhe Privatësi do të jetë në dispozicionin tuaj për çdo këshillë rreth realizimit të këtyre obligimeve ligjore.

Për veprimet e ndërmarra sipas kësaj kërkesë, ju lutem që të njoftoni AIP-në përmes postës elektronike info.aip@rks-gov.net, deri më datë 16 Tetor 2023.

Me respekt,